



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.22, datë 13/10/2023

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES
NR.SERIE 0068, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.20, DATË
22.09.2017 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,
SUBJEKTIT “AMARILTO” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0068, miratuar me Vendimin Nr.20, datë 22.09.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X=4389291; Y=4611688; Z= 10m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X=4390500; Y=4618578; Z= 10m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=473618; Y=4617657; Z= 10 m.m.n.d (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.3 l/s

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike
- 2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0068, miratuar me Vendimin Nr.20, datë 22.09.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat, “leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për ujë teknologjik (Konservim i frutave dhe perimeve)”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, Pllanë, Bashkia Lezhë.
- 3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

